



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:060484

Datë: 01.12.2020

Numri i dokumentit: 01309987

P.nr.991/2020

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm – gjyqtari i vetëm gjykues Kushtrim Shyti, me bashkëpunëtoren profesionale Kristina Shtufi, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.R. nga P....., për veprën penale, Dhuna në Familje parashikuar nga neni 248 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1137/2020 të datës 29.05.2020, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 11.11.2020 në prani të Prokurores së Shtetit Edina Jupolli, të akuzuarit, të njëjtën ditë me datë 11.11.2020, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 01.12.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.R., nga i ati dhe nëna ... e gjinisë, i lindur me, me vendbanim në rr.”.....”, nr....., në, me numër personal, të dhëna këto të vërtetuar nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB-ja, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike,, Shtetas i Republikës së

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

1. Me datë 30.03.2020, rreth orës 19:45, në rrugën ”....”, në ..., konkretisht në shtëpinë e tyre familjare, i pandehuri, për shkak të mosmarrëveshjeve me të dëmtuarin-babain e tij H.R., lidhur me fjalosjen në mes të pandehurit dhe motrës e vëllait të tij dhe tentim sulmin ndaj të njëjtëve nga ana e të pandehurit, në atë momente ka ndërhyrë i dëmtuari H... duke e penguar të pandehurin, mirëpo i njëjti tenton ta godas edhe të dëmtuarin, ndërsa e ndaluan bashkëshortja dhe djali i të dëmtuarit, atëherë i pandehuri ishte bërë nervoz dhe e kërcënoj të njëjtin me këto fjalë kërcënuese „Deri neser në ora 15:00 i dua 2500€, ose do të këpus në mes dhe do të lë në karrocë“, „ty dhe E... do t’ju lë në karrocë, më lironi shtëpinë dhe nuk të intereson çka bëje une“, si pasojë e këtyre veprimeve të dëmtuarit i ka shkaktuar ndjenjën e frikës, ankthit dhe pasigurisë për jetë.

- me këtë i akuzuari ka kryer veprën penale Dhunë në Familje nga neni 248 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 21, 38, 40, 46, 47, 48, 49, 69 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365, 450, 453 të KPPRK-së, të akuzuarin:

E GJYKON

1. Dënim burgimi me kusht në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, si dhe dënimin me gjobë me kusht në shumën treqind (300) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale apo të ngjashme.
2. Nëse revokohet dënimi me gjobë me kusht i njëjti dënimin e shqiptuar me gjobë mund të paguaj, me tre këste me se largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimin ndërpritet.
3. I akuzuari obligohet që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej tridhjetë (30) euro, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej tridhjetë (30) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
4. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontestin e rregullt civil - juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1137/2020 të datës 29.05.2020, kundër E.R., për veprën penale Dhunë në Familje parashikuar nga neni 248 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 11.11.2020, në të cilën kanë prezantuar Prokurorja e shtetit Edina Jupolli, i akuzuari E.R..

I akuzuari në shqyrtimin fillestar me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit, PP/II.nr.1137/2020 të datës 29.05.2020, i njëjti ka deklaruar se ndihet i penduar për veprën që e ka bërë, i kërkon falje prindit-babait, premton para gjykatës se nuk do të përsëris këtë veprë penale, kërkon nga gjykata që ti jep një dënim sa më të butë pasi i ka kushtet e dobëta ekonomike.

Prokurori i Shtetit dha mendimin e tij lidhur me deklarin e fajësisë së të akuzuarit, dhe shtoi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe se e njëjta është bërë konform

nenit 248 të KPPRK-së, i propozojmë Gjykatës, të merret parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 250 par.1 nënpar.1.1 deri 1.4 të KPPRK-së. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPRK-së, lidhur me pranimin e fajësisë.

Nga thëniet e vet të akuzuarit në shqyrtimin fillestar i cili e pranoi fajësinë u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Po ashtu edhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit i datës 30.03.2020, procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin H.R. i datës 30.03.2020, procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin i dt.30.03.2020, si dhe shkresat tjera të lëndës gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale, Dhuna në Familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i akuzuari. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoji si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin lidhur me veprën e kryer, premtimin para Gjykatës se nuk do të përsëris veprat penale, rrethana rënduese gjeti rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale dhe faktin se i akuzuari veprat penale e ka kryer në ambiente familjare, andaj të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar dënim me kusht në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj vepre penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmën si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, në kompensimin e palës së dëmtuar për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale, gjykata ka vendosur në përputhje me nenin 450 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr.05/L-036.

Lidhur me kërkesën pasurore-juridike, gjykata ka vendosur në përputhje me nenin 463 par.2 të KPPRK-së, pasi që nuk kishte prova të mjaftueshme për të vendosur për kërkesën pasurore juridike, pasi që në rastet kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të përsëritshëm, gjykata i udhëzon të dëmtuarit që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojnë në kontest civil, kjo ngase gjykata e kishte të pamundur të vendoste në mënyrë meritore.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.991/2020 Datë 01.12.2020

Bashkëpunëtore profesionale
Kristina Shtufi

Gjyqtari
Kushtrim Shyti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.